



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 640 Prot.

Tiranë, më 27. 12. 2022

RAPORT I AKTIVITETIT TË
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË
PËR PERIUDHËN KOHORE
JANAR- DHJETOR 2022

Miratoi

Eduart MAKRI

KRYETAR



Bul. "Aleksandër Moisiu", Nr.77, Tiranë

Tel/Fax. 378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al

Website: www.nationalfilmcenter.gov.al

Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit dhe misionit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK)

QKK është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë" të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është mbështetja financiare dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri.

QKK, që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar, si dhe projekteve të ndryshme kinematografike dhe festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit.

Për arsye të buxhetit të pamjaftueshëm, këtë vit nuk u hapën thirrjet për aplikim për filmin me metrazh të gjatë, minority co-production, zhvillim projekti si dhe projekte të ndryshme kinematografike.

Në vitin 2022 pas procesit të vlerësimit fituan të drejtën për financim 19 projekte.

Më konkretisht:

- ✓ 4 Filma dokumentarë;
- ✓ 2 Filma të animuar
- ✓ 6 Filma artistikë me metrazh të shkurtër (temë diplome "Bachelor" të studentëve të UA);
- ✓ 1 Projekt për javë filmi;
- ✓ 6 Festivale Ndërkombëtare Filmi.

1. Filma të përfunduar gjatë vitit dhe që kanë realizuar premierat:

Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun 18 projekte filmike, si më poshtë:

I.I. Filma artistikë metrazh të gjatë:

1. **"Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo"**– skenari (adaptuar nga romani me të njëjtin titull i Dritëro Agollit) dhe regjia Fatmir Koçi;
2. **"Një filxhan Kafe dhe këpucë të reja veshur"** – skenari dhe regjia Gentian Koçi.

I.II. Filma artistikë metrazh të gjatë- vepër e parë:

1. **“Xixëllonjat”** - skenari dhe regjia Artur Gorishti;
2. **“Legjenda e bastunit”** – skenari Mihal Rama dhe Xhoslin Rama, regjia Xhoslin Rama;
3. **“Nji prej nesh”** – skenari dhe regjia Ergys Meta.

I.III. Filma artistikë metrazh të gjatë- Minority Co-production:

1. **“Vera andrron Detin”** - skenari Doruntina Basha dhe regjia Kaltrina Krasniqi.
2. **“Lëkura e krokodilit”** – skenari dhe Ilirian Himaj.
3. **“I love you more”** – skenari dhe regjia Erblin Nushi.

II. Filma artistikë me metrazh të shkurtër:

1. **“Pelikanët e zinj”**- skenari dhe regjia Luli Bitri.
2. Filmata të diplomës “Bachelor” të studentëve të vitit akademik 2021-2022 të Universitetit të Arteve
 - ✓ **“Punë me zarar”**, regjia Ardit Vila
 - ✓ **“Shkrepe”**, regjia Edinjo Jahja
 - ✓ **“Lucid”**, regjia Enkel Mema
 - ✓ **“Fëmija”**, regjia Enton Lazaj
 - ✓ **“Flatline”**, regjia Fatjona Katroshi
 - ✓ **“Rasti i çuditshëm i Terezitës”**, regjia Renis Hyka

III. Filma dokumentarë:

- **Filmi “Bekim Fehmiu”** – skenari Fahri Musliu dhe regjia Valmir Tertini.

IV. Filma të animuar:

- ✓ **“Burri”** - skenari dhe regjia Artur Dauti;
- ✓ **“Man Wanted”** - skenari dhe regjia Irida Zhonga;
- ✓ **“Kukulla”**- skenari dhe regjia Artan Maku;
- ✓ **“Gilgameshi”** – skenari dhe regjia Shaqir Veseli.

2. Festivale ndërkombëtare brenda vendit gjatë vitit 2022:

- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec, Qershor;
- ✓ Dea Open Air International Film Festival, Tiranë, Qershor;
- ✓ KO:SH Film Festival, Korçë, Korrik;

- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut, Tiranë, Shtator;
- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Filmit "TIFF", Tiranë, Shtator;
- ✓ Festivali Ndërkombëtar i Filmit "A-Film Fest", Tetor Gjirokastrë dhe Nëntor Shkodër;
- ✓ Projekti "Open Cinema-VI", në 12 rrethet e vendit, Qershor – Shtator 2022.

3. Projekte filmike të xhiruara gjatë vitit 2022:

I. Filma artistikë me metrazh të gjatë:

- ✓ "Këtu vallëzohet me hijet", regjia Pluton Vasi;
- ✓ "Luna Park", regjia Florenc Papas;
- ✓ "Misioni", regjia Andi Deliana;
- ✓ "Sirin", (Minority Co-production), regjia Senad Sahmanović.

II. Filma të shkurtër:

- ✓ 6 filma të shkurtër të diplomimit në "Bachelor" të studenteve të vitit akademik 2021-2022 të Universitetit të Arteve.

III. Filma të animuar:

- ✓ "Fani në kërkim të dritës" – regjia Artur Dauti;
- ✓ "Milo" – regjia Fatjon Alla;
- ✓ "Legjenda e Argjirosë" – Eljona Thomaraj.

IV. Filma dokumentarë:

- ✓ "Plani i anijes" – regjia Ardit Sadiku;
- ✓ "Lamtumirë Pelikul 35 mm" – Rigters Plaku;
- ✓ "Rikard" - regjia Mevlan Shanaj.

4. Përfaqësim në festivale filmi dhe aktivitete të tjera të rëndësishme ndërkombëtare dhe vlerësimet me çmime:

- I. Konkurim zyrtar në Tallin Black Nights Film Festival, Estoni i filmit "Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur", regjia Gentian Koçi.

- II. Përzgjedhje në sesionin "*Zgjedhjet e Kritikëve*" në Tallin Black Nights Film Festival i filmit "**Shkëlqimi dhe Rënia e Shokut Zylo**", regjia Fatmir Koçi.
- III. Konkurim zyrtar në Cottbus Film Festival i filmit "**Nji prej nesh**", regjia Ergys Meta.
- IV. Konkurim zyrtar dhe vlerësim me çmime për filmin "**Virgjëresha Shqiptare**" (Minority Co-production), regjia Bujar Alimani:
 - ✓ Euromillions Audience Awards në Ostende Film Festival – Belgjikë;
 - ✓ Best Balkan Film - Vjosa Berisha Award në Prishtina International Film Festival.
- V. Konkurim zyrtar dhe vlerësim me çmimin International Ingmar Bergman Award, në Göteborg Film Festival për filmin "**Vera andrron detin**", regjia Kaltrina Krasniqi.
- VI. Konkurim zyrtar i filmit "**Internimi**", regjia Kast Hasa, në edicionin e XV të festivalit të filmit "**Hyjnesha në Fron**", ku u vlerësua me çmimet:
 - ✓ Filmi më i mirë.
 - ✓ Aktori më i mirë.
- VII. Konkurim zyrtar i filmit "**Portreti i pambaruar**", regjia Namik Ajazi fiton 3 çmime në Cilento International Film Festival:
 - ✓ Çmimi Filmi ndërkombëtar më i Mirë;
 - ✓ Çmimi për Fotografinë më të mirë;
 - ✓ Çmimi Aktorja më e mirë Jo-protagoniste.
- VIII. Konkurim zyrtar i filmit "**Pasojat e Lirisë**", regjia Lorin Terezi fiton çmimin Projekti më i Mirë në Cyprus Film Days International Film Festival.
- IX. Konkurim zyrtar i filmit "**After Dark**", i regjisorit Erenik Beqiri fiton çmimin **Region Sud Prize** në Mediterranean Co-production Forum, Marseille.
- X. Pjesëmarrje e QKK me një pavion të përbashkët me Qendrën Kinematografike të Kosovës në Marketin e Filmit të Kanës, Maj 2022.

5. Akte ligjore dhe projektakte:

- I. Gjatë marketit të filmit në Cannes 2022, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve kinematografike, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Centre National du Cinéma et de l'Image Animée (CNC). Marrëveshja u nënshkrua ndërmjet Kryetarit të QKK, Z.Eduart Makri, dhe Z.Olivier Henrard.

- II. Hartimi i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar”, si dhe relacioni përkatës. Ky ka qenë një proces i shtrirë gjatë gjithë vitit, i cili sëbashku me përgatitjen e RIA-s ishte një impenjim i madh për një pjesë të stafit të QKK.

6. Të dhëna për buxhetin e vitit 2022

Buxheti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për vitin 2022, në total është 173,386,250 Lekë, prej të cilave:

- ✓ 128,831,000 Lekë, financime për projektet kinematografike;
- ✓ 15,600,000 Lekë, financim për projektet e Akademisë së Filmit dhe Multimedias “MARUBI” (akorduar me akt normativ);
- ✓ 15,895,000 Lekë, transferta me jashtë;
- ✓ 12,060,250 Lekë, paga, sigurime dhe shpenzime operative;
- ✓ 1,000,000 Lekë, zëri Investime.

Të ardhurat dytësore janë realizuar në masën 43,300,00 Lekë, të cilat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.